LIGJ
Nr.8219, datë 13.5.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8001, DATË 22.9.1995 "PËR GENOCIDIN DHE KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT KRYER NË SHQIPËRI GJATË SUNDIMIT KOMUNIST PËR MOTIVE POLITIKE, IDEOLOGJIKE DHE FETARE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Presidentit të Republikës

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Neni 3 i ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 "Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare", ndryshohet si vijon:

"Nuk mund të zgjidhen paskëtaj deputetë në Kuvendin Popullor dhe kryetarë bashkie dhe as të emërohen në administartën e lartë të shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia, deri në 31 dhjetor 2001 autorët, ideatorët dhe zbatuesit e krimeve të mësipërme, që kanë qenë ish-anëtarë të Byrosë Politike, ish-punonjës të Sigurimit të Shtetit, ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit, denoncuesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike, me përjashtim të rasteve kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike, si dhe personat e dënuar me vendim të gjykatës për krime kundër njerëzimit.

Ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit, si dhe denoncuesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike përjashtohen nga ky rregull edhe në rast se nuk e kanë ushtruar më veprimtarinë në 20 vjetët e fundit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më datën 13.5.1997.

Shpallur me dekretin nr.1793, datë 16.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha